

Shtojca 20

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

Primus Albania sh.p.k.

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L42202028V

Nuis/Nipt

Rr. "Margarita Tutulani", Pallati Viridario 1, Tiranë

Adresa

Tiranë

Shqipëri

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

0696000055

N/A

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

E-mail: info@primus.com.al / denisa.sala@primus.com.al

Denisa Sala – Drejtor Ekzekutiv

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

31.05.2023

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0696000055

N/A

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

REF- 70269-05-24-2023

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur

Procedurë e kufizuar

Partneritet për inovacion

Procedurë me negociim me
shpallje parapraketënjoftimit

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga
procedurat e prokurimit të parashikuara në
LPP

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë konkurruese me negociim

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim pa shpallje
paraprake të njoftimit të kontratës

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Ujësjetës Kanalizime Kamëz sh.a.

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) Lek

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).

Zhvillim dhe Mirëmbajtje të sistemit të faturimit

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

05.06.2023

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

N/A

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

N/A

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij

Dokumentet Standarte të Tenderit

Specifikimet Teknike

Proces-Verbali “Për rgumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Në datë 25.05.2023 në Sistemin Elektronik të Prokurimeve (SEP) të Agjencisë të Prokurimit Publik (APP) identifikua publikimin e procedurë së prokurimit nr. REF-70269-05-24-2023 me objekt prokurimi “Zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit”, me fond limit 1,800,000 lek publikuar nga Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh. A. Afati i dorëzimit të ofertave është data 05.06.2023, ora 10:00, si më poshtë:

"Zhvillim dhe Mirembajtje te sistemit te faturimit"

Profil/Perudha	Formularët e Vlerësimit	Dokumentet e Tenderit	Njoftimet e Kontratës	Kërkesat
Objekti i Procedurës				
"Zhvillim dhe Mirembajtje te sistemit te faturimit"				
Procedurat	E hapur, e thjeshtuar	Tipi i Kontratës	Shërbime	
Njoftimi Përfshin	Kontratë Publike	Numri	REF-70269-05-24-2023	
Data e Hapjes se Tenderit	25.5.2023 09:00	Afati i Fundit per Pranimin e Ofertave	5.6.2023 16:00	
Vlera e Përllogaritur	1.300.000,00	Autoriteti Kontraktues	Ujesjelles-Kanalizime Kamez Sh.a	
Kodi CPV	48444100-3			
Kohëzgjatja				
Marrëveshja Kuader				

Duke qënë të inetersuar për këtë procedurë prokurimi dhe pasi identifikuam disa parregullsi në dokumentet e tenderit, po kërkojmë sipas rastit heqjen/modifikimin e formulimit të tyre.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

I. Në objektin e kontratës është kërkuar "Zhvillim dhe Mirembajtje te sistemit te faturimit". Ndërsa në Specifikimet Teknike në kapitullin Hyrje dhe më pas është shpjeguar si më poshtë:

Ujesjelles Kanalizime Kamez ne vijim UK ka rreth 25.000 abonente. Bazuar ne Ligjin Nr 87/2019. Për faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Udhezim nr 16 date 03.04.2020 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Vendim Nr 239 datë 20.03.2020 Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurë e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimin e prodhuesve e te mirëmbajtesve të zgjidhjeve software-ike UK Kamez kerkon te fiskalizoje faturat e abonenteve. UK Kamez menaxhon te dhenat e abonenteve me ane te sistemit te faturmit. UK Kamez kerkon te mirmbaje sistemin e faturmit qe disponon dhe te integroje nje program fiskalizimi me kete sistem qe te beje te mundur fiskalizimin automatik te faturave. Gjithashtu programi i fiskalizimit duhet qe te transmetoje ne kohe reale te gjitha veprimet e arkave ne sistemin.

Programi i Fiskalizimit dhe i Faturimit

Funksionalitetet që duhet të ketë programi i fiskalizimit dhe mirmbatja e programit te faturimit.

...

Gjithashtu në Shtojcën 8 Formular i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit keni kërkuar:

- 2.3.4** *Autorizimi i Prodhuesit per zgjidhjen e ofruar te Programit te Fiskalizimit, i cili te specifikojë projektin, daten, adresen e qarte te prodhuesit dhe te bashkengjise certifikaten e regjistrimit te sistemit.*
- 2.3.5** *Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga AKSHI dhe DPT për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.*

6

Pra, referuar Specifikimeve Teknike dhe kriterëve 2.3.4 dhe 2.3.5, rezulton që përveç zhvillimit dhe mirëmbajtjes të sistemit të faturimit, sipas objektit të kontratës, është e qartë që ju keni kërkuar instalimin e një programi fiskalizimi, ndërkohë që kjo kërkesë, pra furnizimi i një programi kompjuterik fiskalizimi, nuk pasqyrohet në vetë objektin e kontratës.

Duke e konsideruar si të paplotë dhe në kundërshtim me ligjin, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin/modifikimin e objektit të kontratës dhe përfshirjen në të në formë të sintetizuar të të gjithë nënobjektivave që do duhet të realizojë kontraktori.

- II. Megjithëse në objektin e kontratës është kërkuar “Zhvillim dhe Mirëmbajtje të sistemit të faturimit”, në Specifikimet Teknike, Termat e Referencës apo në DST, nuk është dhënë asnjë detaj/hollësi teknike mbi sistemin e faturimit që përdor sot Autoriteti Kontraktor (AK) dhe çfarë shërbimesh synon të realizojë me kërkesën “zhvillim të sistemit të faturimit” dhe kërkesën “mirëmbajtje të sistemit të faturimit”.

Kjo bie ndesh me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 1, citojmë si më poshtë:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

Këto detaje teknike mungojnë në DST dhe Specifikimet Teknike që ju keni publikuar.

Përgjithësisht termi “zhvillim” përdoret në rastin e realizimit nga fillimi të një programi kompjuterik. Mqs ju shprehni se tashmë e keni në përdorim një program/sistem faturimi, vlerësojmë që termat më të mundshme në këtë rast do të ishin “përditësim”, “përmirësim”, etj. dhe në këtë rast do të duhej të listoheshin objektivat që synon të arrijë AK lidhur me sistemin e faturimit aktual.

Përsa më sipër kërkojmë të plotësohen termat e referencës/specifikimet teknike me detajet teknike të sistemit dhe kërkesat teknike se çfarë synon AK të realizojë për sistemin e faturimit, konkretisht për përmirësimin e tij, si dhe për mirëmbajtjen e tij.

- III. Në Shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, keni kërkuar sa më poshtë:

Shërbimet që kërkohen: Bashkangjitur dokumentave në SPE

Afatet e ekzekutimit:

- 1. Afati i implementimit 24 ore nga lidhja e Kontrates*
- 2. Afati i shërbimit 12 muaj nga data e lidhja e Kontrates*

Në shtojcën 6 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit”, shtojcën 2 “Lista e Çmimeve të Shërbimeve”, por edhe në asnjë pjesë të DST dhe Specifikimet Teknike nuk gjendet një tabelë me shërbimet dhe furnizimet që ju kërkoni, megjithëse kemi evidentuar të paktën tre shërbime/furnizime

që ju kërkoni, i) zhvillim të sistemit të faturimit (që ndoshta do duhet korrigjuar nga zhvillim në përmirësim apo përditesim, mqs siç ju shpreheni e keni tashmë në përdorim një sistem faturimi); ii) mirëmbajtje të sistemit të faturimit dhe iii) furnizim të programit të faturimit. Secili nga këto shërbime/furnizime ka koston përkatëse, por mbi të gjitha kohën e lëvrimin të tyre që lidhet pas realizimit me faturimin e tyre.

Përsa më sipër kërkohet të plotësohet Shtojca 6 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit” dhe/ose Shtojca 2 “Lista e Çmimeve të Shërbimeve” me Formularin e Shërbimeve dhe afatin e realizimit të tyre sipas planifikimit të vetë AK.

IV. Në Shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, keni kërkuar sa më poshtë:

Shërbimet që kërkohen: Bashkangjitur dokumentave ne SPE

Afatet e ekzekutimit:

- 1. Afati i implementimit 24 ore nga lidhja e Kontrates*
- 2. Afati i shërbimit 12 muaj nga data e lidhja e Kontrates*

Pra, referuar Specifikimeve Teknike, ju keni kërkuar që implementimi i programit të fiskalizimit (pasi programin/sistemin e faturimit ju e keni në përdorim tashmë dhe nuk mund të bëhet fjalë për implementim të tij) të kryhet brenda 24 orëve(!) nga nënshkrimi i kontratës. Nga përvoja e derisotme, pavarësisht kompleksitetit të një programi kompjuterik, nuk kemi hasur dhe nuk e vlerësojmë realisht të mundshme implementimin e një programi kompjuterik brenda 24 orëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Referuar sa më sipër, kërkohet modifikimin e afatit të implementimit të programit nga 24 orë në të paktën 5 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

V. Në kapitullin Njoftimi i Kontratës në pikën 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera, thuhet shprehimisht:

Specifikoni nëse autoriteti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

Ju nuk keni klikuar asnjërin nga dy opsionet e përcaktuara më sipër, duke i lënë praktikisht të mundshme të dy opsionet.

Duke e konsideruar si të paplotë dhe në kundërshtim me ligjin, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin e këtij kriteri.

VI. Në Shtojcën 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.2 (a) keni kërkuar:

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të pakten 5 punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkencë kompjuterike etj). Plotësimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve.*

a) *Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar si "Arkitekt të Certifikuar" në zgjidhjen e ofruar. Kjo të vërtetohet nepermjet paraqitjes së Certifikates së leshuar nga një kompani e licensuar nga autoritetet perkatese shteterore. Kjo kompani të jete vet prodhuesi i sistemit ose perndryshe të jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit për të leshuar ate lloj certifikate.*

Duke mos e patur të qartë se për çfarë zgjidhje (nënkupto program) kërkohen këto 2 punonjës të certifikuar si "Arkitekt të Certifikuar" në zgjidhjen e ofruar, po i referohemi kërkesës për furnizimin me programin e fiskalizimit, pasi zgjidhja e ofruar mund t'i referohet vetëm këtij rasti, programit të fiskalizimit. Për sistemin e faturimit, të cilin e keni tashmë në përdorim, ju nuk keni dhënë e shpjeguar detaje mbi teknologjinë e ndërtimit të tij, etj.

Në Shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, keni kërkuar sa më poshtë:

Shërbimet që kërkohen: Bashkangjitur dokumentave në SPE

Afatet e ekzekutimit:

- 1. Afati i implementimit 24 ore nga lidhja e Kontrates*
- 2. Afati i shërbimit 12 muaj nga data e lidhja e Kontrates*

Pra, ju keni kërkuar që implementimi i programit të fiskalizimit (pasi programin/sistemin e faturimit ju e keni në përdorim tashmë dhe nuk mund të bëhet fjalë për implementim të tij) të kryhet brenda 24 orëve(!) nga nënshkrimi i kontratës. Kjo nënkupton që operatori ekonomik/kontraktori do duhet të ketë një produkt (program fiskalizimi) të gatshëm.

Nëse qëndron arsyeja e mesazhit, vetvetiu lind pyetja: Përse do i duhen operatorit ekonomik/kontraktori 2 punonjës të certifikuar si "Arkitekt të Certifikuar" në zgjidhjen e ofruar përderisa produkti është i gatshëm dhe kërkohet të instalohet brenda 24 orëve? Pra nga AK nuk është kërkuar të zhvillohet një program i ri fiskalizimi, i cili veç të tjerash do të donte një bilanc kohor të konsiderueshëm marrë parasysh zhvillimin e tij dhe më pas regjistrimin/licensimin pranë AKSHI-t dhe DPT-së (shumë e shumë përtej 24 orëve).

Edhe argumentimi i këtij kriteri në proces-verbalin "Për argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim", si më poshtë:

Argumentimi: Qe te sigurohet aftesia per implementimin e kerkesave per ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteve, etj, kerkohet qe OE duhet te kete ne stafin e propozuar te pakten 2 personel me njohuri/aftesi te nevojshme te certifikuara nga prodhuesi i teknologjive baze te sistemit.

nuk përputhet me Specifikimet Teknike dhe kërkesat për sistemin e fiskalizimit.

Në kërkesat për programin/sistemin e fiskalizimit ju në asnjë rast nuk keni parashikuar kërkesa për ndryshim, zgjerim funksionalitetesh, etj. që më pas të parashikoni ekspertët që do duhen për këto raste.

Kërkesa/kriteri i mësipërm bie ndesh me përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3, citojmë si më poshtë:

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Pra, kërkesën/kriterin e mësipërm e konsiderojmë jo në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Referuar sa më sipër, kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë e cila nuk është në përputhje me objektin e kontratës.

Ndërkohë formulimi i kërkesës së mësipërme nënkupton që çertifikatat e lëshuara për “Ekspertët e Çertifikuar” duhet të bëhen nga kompania që ka prodhuar sistemin e ofruar ose nga një kompani e autorizuar prej prodhuesit të sistemit.

Ky formulim bie ndesh me vendimin e KPP 277/2022 fq. 7, ku ndër të tjera shprehet:

...

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i termave të referencës/specifikimet teknike, Komisioni gjykon se bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat për disponimin e punonjësve të certifikuar në kategoritë e kualifikimeve të mësipërme nuk janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet, që operatorët ekonomikë ofertues disponojnë stafin me aftësitë dhe ekspertizat e duhura për të zbatuar me sukses kontratën objekt-prokurimi. Por, përcaktimi i certifikatave të lëshuara nga kompani të posaçme, gjuhë programimi dhe për kualifikime mbi produkte të prodhuara nga këto të fundit, kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën dhe gamën e zgjidhjeve të propozuara, si dhe bie në kundërshtim edhe me vetë përcaktimet e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike, ku evidentohet se zgjidhja është lënë në diskrecion të operatorëve ekonomikë.

Dhe vendimin e KPP nr. 386/2023, fq. 36, ku ndër të tjera shprehet sa më poshtë:

...

Në rastin konkret, Komisioni konstaton, se kërkesa e entit prokurues që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin e tij përsona që kanë aftësinë profesionale për zhvillim dhe implementim e zgjidhjes se kërkuar në specifikimet teknike është një kërkesë e cila është në përputhje me objektin e prokurimit, ndërsa kërkesa që këta punonjës të jenë të certifikuar nga vetë prodhuesi ose kompani të autorizuar nga prodhuesi, ku këta të fundit të jenë të licensuara nga autoritetet shtetërore për të lëshuar këto certifikata është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, pasi zhvillimi i sistemeve bëhet nga përsona të cilët kanë arsimin e duhur dhe formimin profesional për të zhvilluar këto sisteme në platforma të caktuara në varësi të kërkesës së autoritetit kontraktor, prandaj Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin kualifikues ...

Pra, kërkesa juaj "Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Certifikates se leshuar nga nje kompani e licensuar nga autoritetet perkatese shteterore. Kjo kompani te jete vet prodhuesi i sistemit ose perndryshe te jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit per te leshuar ate lloj certificate", është në kundërshtim me vendimet e KPP të sipërcituara.

VII. Në Shtojcën 8 Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.2 (b) keni kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 5 punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj). Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se hapjes se ofertave dhe diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve.

(b) Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 specialist te certifikuar si "Ekspert i certifikuar" ne zhvillim dhe implementim te programeve te faturimit. Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Certifikates se leshuar nga nje kompani e licensuar nga autoritetet perkatese shteterore. Kjo kompani te jete vet prodhuesi i sistemit ose perndryshe te jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit per te leshuar ate lloj certificate.

Formulimi i kërkesës së mësipërme nënkupton që certifikatat e lëshuara për "Ekspertët e Çertifikuar" duhet të bëhen nga kompania që ka prodhuar sistemin e ofruar ose nga një kompani e autorizuar prej prodhuesit të sistemit.

Ky formulim bie ndesh me vendimin e KPP 277/2022 fq. 7, ku ndër të tjera shprehet:

...

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i termave të referencës/specifikimet teknike, Komisioni gjykon se bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat për disponimin e punonjësve të certifikuar në kategoritë e kualifikimeve të mësipërme nuk janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet, që operatorët ekonomikë ofertues disponojnë stafin me aftësitë dhe ekspertizat e duhura për të zbatuar me sukses kontratën objekt-prokurimi. Por, përcaktimi i certifikatave të lëshuara nga kompani të posaçme, gjuhë programimi dhe për kualifikime mbi produkte të prodhuara nga këto të fundit, kufizon në mënyrë të panevojshme

konkurrencën dhe gamën e zgjidhjeve të propozuara, si dhe bie në kundërshtim edhe me vetë përcaktimet e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike, ku evidentohet se zgjidhja është lënë në diskrecion të operatorëve ekonomikë.

Dhe vendimin e KPP nr. 386/2023, fq. 36, ku ndër të tjera shprehet sa më poshtë:

...

Në rastin konkret, Komisioni konstaton, se kërkesa e entit prokurues që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin e tij përsona që kanë aftësinë profesionale për zhvillim dhe implementim e zgjidhjes se kërkuar në specifikimet teknike është një kërkesë e cila është në përputhje me objektin e prokurimit, ndërsa kërkesa që këta punonjës të jenë të certifikuar nga vetë prodhuesi ose kompani të autorizuar nga prodhuesi, ku këta të fundit të jenë të licensuara nga autoritetet shtetërore për të lëshuar këto certifikata është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, pasi zhvillimi i sistemeve bëhet nga përsona të cilët kanë arsimin e duhur dhe formimin profesional për të zhvilluar këto sisteme në platforma të caktuara në varësi të kërkesës së autoritetit kontraktor, prandaj Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin kualifikues ...

Pra, kërkesa juaj “Kjo të vertetohet nepermjet paraqitjes së Certifikates së lëshuar nga nje kompani e licensuar nga autoritetet perkatese shteterore. Kjo kompani te jete vet prodhuesi i sistemit ose perndryshe te jete e autorizuar nga prodhuesi i sistemit per te lëshuar ate lloj certifikate”, është në kundërshtim me vendimet e KPP të sipërcituara

Referuar sa më sipër, kërkojmë modifikimin e kësaj kërkesë në përputhje përcaktimet ligjore dhe vendimet e KPP.

VIII. Në Shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.3 keni kërkuar:

2.3.3 Operatori Ekonomik konkurues duhet të jete i certifikuar me:

- ISO 9001 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë) e perditësuar
- ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit) e perditësuar
- BS PASS 99:2012 (Menaxhimi i sistemeve te integruar) e perditësuar

*Në rastin e bashkimit të operatoreve Certifikatat e mësipërme duhet të paraqiten nga secili OE

Këto certifikime të kërkuara, lëshuar nga organizma certifikues, sipas datës së vlefshmërisë së tyre ose janë të vlefshme ose i ka kaluar afati i vlefshmërisë në datën e përdorimit të tyre për procedurën e prokurimit referencë, ndaj cilësimi i tyre “e përditësuar” është e pakuptimtë dhe mund të krijojë keqinterpretime.

Vetë kodi i tyre dhe objekti të cilin ju keni formuluar për çdo certifikatë të listuar jep në mënyrë shteruese dhe paekuivok llojin e certifikatës që ju kërkoni.

Ndërkohë ju sjellim në vëmendje vendimin e KPP nr. 386/2023, fq. 23, ku ndër të tjera shprehet sa më poshtë:

...

Lidhur me pretendimin e mësipërm të ankimesit, përsa i përket termit “e përditësuar” në lidhje me çertifikatat ISO të kërkuara në kriterin kualifikues të pikës 2.3.2 të Shtojës 8 “Formular i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2, duke hequr termin “e përditësuar”, pasi vendosja e këtij termi është në tejkalim të përcaktimeve të nenit 44 të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe vlefshmëria e çertifikatave të sipërpëmendura është objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të dorëzuara sipas parashikimeve të nenit 82 të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër kërkojmë heqjen e termit “e përditësuar” pas çertifikatave të listuara më lart.

IX. Në Shtojcën 8 Formular i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikat 2.3.4 dhe 2.3.5 keni kërkuar si më poshtë:

- 2.3.4 *Autorizimi i Prodhuesit për zgjidhjen e ofruar të Programit të Fiskalizimit, i cili të specifikojë projektin, datën, adresën e qartë të prodhuesit dhe të bashkëngjise certifikatën e regjistrimit të sistemit.*
- 2.3.5 *Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga AKSHI dhe DPT për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.*

Të ndara në dy kërkesa të veçanta, këto kërkesa, që në vetvete janë një, krijojnë konfuzion dhe paqartësi më pas në vlerësimin e ofertave teknike të paraqitura.

Kërkesa 2.3.5 është korrekte dhe bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi. Operatorët Ekonomikë, referuar vetë programit specifik të fiskalizimit dhe bazuar në VKM nr.239 datë 20.03.2020 “Për kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software-ike për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedurën e kriereve për regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike”, si Prodhues të programit, kanë detyrimin të licensohen nga AKSHI dhe DPT në rastin e ofrimit të programeve kompjuterike të fiskalizimit dhe ligjërimi i ofrimit të atyre programeve bëhet mbi bazën e këtij licensimi. Në këtë licensë të lëshuar nga dy institucione, AKSHI dhe DPT, përcaktohet emërtimi i programit kompjuterik të fiskalizimit, numri serial, data e lëshimit/prodhimit, prodhuesi, NUIS i prodhuesit, kodi i prodhuesit dhe/ose mirëmbajtësit, etj. Çertifikatat publikohen në faqet zyrtare të internetit të AKSHI-t dhe DPT.

Ndërkohë kërkesa e pikës 2.3.4 ezaurohet në pikën 2.3.5, pasi në këtë pikë është vendosur edhe opsioni “... ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit” ndaj kriterit 2.3.4 na duket i tepërt, i pakuptimtë dhe do të krijojë keqinterpretime në fazën e vlerësimit teknik të ofertave.

Referuar sa më sipër ne kërkojmë heqjen e kriterit 2.3.4.

- X.** Në Shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikat 2.3.6 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.6 Oferte Teknike qe permbush specifikimet teknike te dhena ne shtojcen perkatese. Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Ju kujtojmë që në fazën procedurale të dorëzimit të ofertave kjo kërkesë përmbushet me anë të shtojcës 9. Formluari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, konkretisht:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimittë përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.</i>	<i>Po [] Jo []</i>

Personi i kontaktit përgjithësisht është personi që nënshkruan dokumentet e ofertës. Dokumentet e ofertës japin edhe informacione të tjera plotësuese, si adresa e operatorit ekonomik, numër telefoni, adresë e-mail, etj., ndaj kjo kërkesë nisur edhe nga fakti që nuk qartësohet se për çfarë kategorie përfaqësimi të personelit të kontakti bëhet fjalë (personel administrativ-ligjor, teknik, etj) na duket e tepërt dhe që mund të krijojë keqinterpretime gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Referuar sa më sipër ne kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë/kriteri.

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Me respekt,

Denisa SALA
Drejtor Ekzekutiv



Denisa.sala@primus.com.al



